



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 16/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.J, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji, me seli në Prishtinë, rr. “Bekim Fehmiu”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.M, për shkak të anulimit të vendimit nr. V\_886\_2017 të datës 09.02.2017, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 10.10.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 18.10.2022 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. V\_886\_2017 të datës 09.02.2017 të nxjerrë nga i padituri Zyra e Rregullatorit për Energji.

**A r s y e t i m**

Paditësi Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KES/CO), ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) nr. V\_886\_2017 të datës 09.02.2017, si jo i ligjshëm, me arsyetimin se tek konsumatori MAP Burgu i Sigurisë së Lartë, për shkak të dyshimeve në matjen ekzistuese, punëtorët e autorizuar të KEDS-it, me datë 02.12.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë evidentuar se konsumatori ka të vendosur njësinorin kontrollues me nr. 35704746 me TMRR me herës 1500/5A, konstantë C=300, për çfarë paditësi ka arritur në përfundim se gjatë periudhës kontestuese nga muaji 12/2013 deri 11/2014 ky njësinor nuk ka matë energjinë e shpenzuar në rregull për shkak se ka ekzistuar lidhje e kombinuar gabimisht në mes të TMRR-ve, TMT-ve dhe njësinorit. Gjithashtu ka theksuar se KEDS nuk ka lëshuar ndonjë dokument për ndryshimin e kushteve për kyçje në formën e pëlqimit elektroenergjetik apo ndryshimin e pëlqimit elektroenergjetik, përmes procesverbalit në vendngjarje është bërë ndërrimi i vendit të pikës matëse nga objekti i Burgut në objektin e KEDS-it, dokument ky që

do të shërbente si bazë edhe për ndryshimin e pëlqimit elektroenergjetik. Padiësi po ashtu ka shtuar se pas ndërrimit të TMRR, regjistrimi i energjisë elektrike ka qenë i saktë me diferencë shumë të vogël për shkak të humbjeve në LP 10kV dhe transformimin e TS 10/04 kv dhe se mospërputhja e vendit të pikës matëse me pëlqimin energjetik dhe defekti në matjen e KEDS-it nuk do të thotë se energjinë e shpenzuar nga MAP Burgu i Sigurisë së Lartë e matur në njehsorin kontrollues sipas KEDS dhe njehsorin faktik sipas ZRRE duhet neglizhuar dhe faturimi i tillë të anulohet. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka shtuar se pavarësisht rrjedhshmërisë së dokumentacionit dhe kontrollimeve të pikave matëse, kufiri i mjeteve themelore mes Burgut dhe KEDS-it ka qenë në trafo stacionin 35/10kv Batllavë dhe kjo në një mënyrë e detyron KEDS-in që të vendosë pikën matëse në kufirin e mjeteve themelore sipas kodit të shpërndarjes dhe se ndryshimet në PEE zakonisht kryhen vetëm nëse gjatë pranimit teknik të objekteve ka ndonjë ndryshim esenciale teknik ndërsa kur ka ndryshime vetëm si zhvendosja e pikës matëse këto merren si zyrtare vetëm me aplikimin e raporteve dhe procesverbaleve të përshkruara nga ekipet e specializuara të matjes në vendin e ngjarjes dhe prezencën e konsumatorit. Në fund kanë theksuar se nga provat e administruara është provuar baza e kërkesëpadisë dhe se shpenzimi i faturuar nga KEDS në shumë prej 28,150.49 euro është bërë në bazë të energjisë së matur në njehsorin kontrollues nr. .... i cili njehsor ka qenë i instaluar brenda objektit të konsumatorit nga vet konsumatori, ashtu që ka rezultuar se energjia e faturuar ka qenë më e vogël se ajo e konsumuar për faktorin 2.17 që i bie 217%. Sa i përket ndryshimeve në PEE ka theksuar se fillimisht në çdo rast kur konsumatorit e kalon përqindjen e fuqisë së kontraktuar elektrike duhet të kërkojë pëlqim elektroenergjetik, pra plotësimi bëhet me kërkesën e konsumatorit, andaj mospërputhjet e vendit të pikës matëse me pëlqimin energjetik dhe defektet në matje nuk do të thotë se energjia e shpenzuar nga konsumatori e matur në njehsorin kontrollues sipas KEDS dhe njehsorin faktik sipas ZRRE duhet neglizhuar dhe një faturim i tillë të anulohet, prandaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet padia e padiësit KES/CO ashtu që të shfuqizohet në tërësi vendimi i të paditurës ZRRE si i pabazuar.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e padiësit duke theksuar se vendimi i Bordit të ZRRE-së është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë si dhe të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë pasi që padiësi fillimisht me datë 22.11.2013 dhe 18.11.2014 kishte bërë inspektimin dhe në procesverbale ka konstatuar se punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë vendosur për matje Grupin Matës (GM) nr. 97830487, ku janë evidentuar edhe të dhënat e Transformatorit Matës Rrymor (TMRR) = 1000/5A, të Transformatorit Matës të

Tensionit (TMT) = 0.1kv, si dhe konstantë llogaritëse të shpenzimeve  $C=20,000$ , ndërsa në procesverbalin e inspektimit të datës 18.11.2014, punëtorët e autorizuar të KEDS kanë evidentuar se konsumatorit i është bërë ndërrimi i TMRR, nga 1000/5A, në 75/5A si dhe konstantja llogaritëse e shpenzimeve nga  $C=20,000$  në  $C=1,500$ . Gjithashtu ka theksuar se punëtorët e autorizuar të KEDS ka bërë inspektimin e objektit të konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori ka të vendosur njehsorin kontrollues me nr. 37504746, TMRR 1500/5A dhe se konstanta llogaritëse është  $C=300$  dhe se njehsori dhe TMRR nuk janë të vulosura dhe kanë kërkuar të bëhet korrigjimi i nevojshëm në bazë të krahasimit të shpenzimeve, gjë që i padituri pretendon se është në kundërshtim me Pëlqimin Elektroenergjetik të konsumatorit. I Padituri po ashtu ka theksuar se ka mbajtur një takim me paditësin nga ku ka kërkuar ti dorëzohet Pëlqimi Elektroenergjetik i reviduar, marrëveshja për kyçje dhe marrëveshja për bartjen e aseteve të ndërtuara nga konsumatori në KEDS, por KEDS nuk ka arritur të sigurojë asnjërin nga këto dokumente. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se ZRRE ka vendosur të aprovoj ankesën e konsumatorit dhe të obligoj KESCO që të shkarkoj konsumatorin nga korrigjimi i datës 18.12.2014 në vlerë prej 28,150.49 euro sepse ka vërtetuar faktin se pas aplikimit për zgjidhje teknike të konsumatorit në KEDS, të njëjtit i kanë lëshuar konsumatorit pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) me të dhënat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, e më pas konsumatori ka bërë të gjitha investimet e nevojshme konform zgjidhjes teknike të ofruar nga KEDS dhe këto investime ishin pranuar si të rregullta nga vetë KEDS, ndërsa një vit më vonë, konsumatori është ngarkuar me këtë korrigjim shtesë sipas shpenzimeve të regjistruara në njehsorin kontrollues sipas KEDS sepse për të njëjtin nuk ka të dhëna që është vendosur si njehsor kontrollues, por njehsor faktik i vendosur nga vetë konsumatori. Krejt në fund ka theksuar se sipas PEE-së, matja e energjisë do të jetë gjysëm indirekte në TS dhe për këtë qëllim duhet të instalohet njehsori multifunksional (aktive, reaktive, maksigraf) të lidhur përmes TMRR 1500/h dhe sipas raportit teknik mbi pranimin intern të datës 13.11.2013 parashihet se “matja e energjisë elektrik do të bëhet sipas Udhëzimit nga PEE të datës 31.10.2013”, andaj, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe Vendimi i Bordit të ZRRE-së të mbetet në fuqi.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i ZRRE nr. V\_886\_17 i datës 09.02.2017, Procesverbal nr. 021718 i datës 22.11.2013, Procesverbal nr. 001672 i datës 18.11.2014, Procesverbal nr. 1242254 i datës 02.12.2014, Pëlqim Elektroenergjetik nr. 7176 i datës 31.10.2013, Procesverbal nr.7664 i

datës 07.11.2013, Raport Teknik nr. 7938 i datës 13.11.2013, Vendim për formim të komisionit, pa datë, pa numër; Leje hyrje nr. 7508 e datës 05.11.2013, Vendim i KESCO i datës 16.07.2017, Kërkesë për kyçje nr. 7964 e datës 14.11.2013, Kërkesë për kyçje e datës 12.11.2013, Transaksionet e konsumatorit për periudhën 05.01.2014 deri 16.12.2016, Rrjedhja e njehsorit të energjisë nr. 90091132, Korrigjimi i kërkuar nga departamenti i KEDS nr. 1418, Kalkulime në tabela në gjashtë faqe, Ankese e konsumatorit nr. 08/2016 e datës 02.08.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Konsumatori Burgu i Sigurisë së Lartë, me datë 28.06.2016 ka parashtruar ankesë tek paditësi për korrigjimin, përkatësisht për faturimin e lartë të pranuar në shumë prej 28,776.94€. Paditësi me datë 16.07.2016 kishte refuzuar ankesën e konsumatorit me arsyetimin se korrigjimi në vlerë prej 28,150.49€ është bërë në bazë të procesverbalit nr. 1242254 të datës 02.12.2014 në bazë të energjisë së matur në njehsorin kontrollues nr. 35704746.

Kundër vendimit të paditësit, konsumatori me datë 02.08.2016 ka parashtruar ankesë në ZRRE lidhur me korrigjimin e bërë, duke pretenduar se kjo sasi e shpenzimit mund të rrjedhë nga humbjet në rrjetet për shkak se matja e energjisë elektrike bëhet diku 15km larg institucionit.

Bordi i ZRRE me Vendimin V\_886\_2017 të datës 09.02.2017 kanë aprovuar ankesën e konsumatorit MAP Burgu i Sigurisë së Lartë dhe kanë Obliguar KESCO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 90091132 nga korrigjimi nr. 70543DPR-90091132 i datës 18.12.2014 në vlerë prej 28,150.49€.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 1 par. 3, nën-par. 3.7 dhe 3.8 të Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë të cilët përcaktojnë: *“1. Zyra e Rregullatorit për Energji ka përgjegjësitë si në vijim të: ... 3.7. sigurojë se konsumatorët dhe të licencuarit mbrohen me rregulla adekuate për zgjidhjen e kontesteve; 3.8. sigurojë se interesat në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji balancohen në mënyrë adekuate dhe se mbrohen konsumatorët në nevojë”* si dhe në kuptim të nenit 8 par. 1 pika 1.6 që përcakton se: *“1. Përveç përgjegjësive të përcaktuara me këtë ligj, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji: 1.6. marrë vendime dhe nxjerrë rregulla dhe akte tjera*

*nënligjore të përgatitura nga Zyra e Rregullatorit për Energji, në pajtim me këtë ligj ose legjislacionin tjetër.”. Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë (e datës 29 gusht 2011) që përcaktojnë kompetencën e Bordit të ZRRE për trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj vendimeve që merren nga furnizuesi apo operatori i sistemit.*

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara.

Gjykata nga prova Procesverbal nr. 021718 i datës 22.11.2013, ka konstatuar se Korporata Energjetike e Kosovës, tek konsumatori Burgu i Sigurisë së Lartë, ka bërë montimin e pikës matëse me karakteristika: konstanta llogaritëse: 20,000, TMRR: 1000/5/A, TMT 10/01kv.

Nga prova Procesverbal nr. 001672 i datës 18.11.2014, gjykata ka konstatuar se KEDS tek konsumatori Burgu i Sigurisë së Lartë, ka bërë ndërrimin e TMRR-ve dhe kanë montuar TMRR me karakteristika 75/5A ndërsa konstanta llogaritëse = 1,500.

Nga prova Procesverbal nr. 1242254 i datës 02.12.2014, gjykata ka konstatuar se KEDS tek konsumatori Burgu i Sigurisë së Lartë ka konstatuar gjendjen në njehsorin elektrik nr. 35704746, të instaluar në objekt, ku është regjistruar shpenzimi T1= 01200,551, T2= 00723,938; R1 00078,061 dhe R2= 0001367, TMRR me herës të transformimit 1500/5A, konstanta C=300. Gjithashtu ka konstatuar se njehsori dhe TMRR nuk janë të pllombuara.

Nga prova Pëlqim Elektroenergjetik (PEE) nr. 7176 i datës 31.10.2013, gjykata ka konstatuar se konsumatori Ministria e Administratës Publike – Burgu i Sigurisë së Lartë i është dhënë pëlqimi elektroenergjetik me kushtet si në vijim: Fuqia e instaluar e objektit: 1000kVA, fuqia maksimale e njëkohshme: pmnj=551.2kV dhe kushtet teknike në pikën 1 është përcaktuar: *“Furnizimi i objektit me energji elektrike do të bëhet nga trafostacioni vetanak të cilin investitori do ta ndërtojë në afërsi të objektit. TS 10(20)/04kV me Sn= 1000kVA të jetë i tipit “murosur” apo “blindë”. Blloku i TM do të ketë 2+1 kthina 24kV, 630A. Blloku i TU të ketë dalje të mjaftueshme sipas projektit. Lidhja e objektit në tensionin primar do të jetë konform “Zgjidhjes teknike” nr. 9186 të 27.12.2012. Vendi i kyçjes kthina 10 kV e TS 35/10 kV “Batllavë”” dhe në pikën 3 është përcaktuar: “Matja e energjisë elektrike do të jetë gjysëm indirekte në TS. Për këtë qëllim duhet të instalohet njehsori multifunksional (aktive, reaktive, maksigraf) të lidhur përmes TMRR 1500/5. Njehsori të jetë i licensuar nga MTI të Republikës së Kosovës dhe i vendosur në vend të përshtatshëm ku do të ketë qasje për lexim*

*në çdo kohë.” Po ashtu në pikën 6 të PPE është përcaktuar: “Në trafostacionin që ndërtohet, duhet të montohet grupi matës (multifunksional) i cili do të regjistrojë harxhimin e energjisë në trafostacion.”*

Nga prova Procesverbal nr.7664 i datës 07.11.2013, gjykata ka konstatuar se komisioni i KEDS pas analizimit të aspekteve teknike për objektet elektrodistributive: - Kthina 10 (20) kV në TS 35/10 kV Batllavë, LP 10 (20) kV, TS 35/10 kV Batllavë gjerë në TS 10 (20)/0.4 kV Burgu i Sigurisë së Lartë në fshatin Dyz dhe TS 10(20)/0.4 kV Burgu i Sigurisë së Lartë ka konstatuar se objektet e cekura janë ekzekutuar sipas projekteve të aprovuara nga ana e investitorit dhe të njëjtat janë ndërtuar në harmoni me rregullat dhe normat ekzistuese për objektet e këtij lloji.

Nga prova Raport Teknik nr. 7938 i datës 13.11.2013, gjykata ka konstatuar se KEDS ka bërë pranimin teknik të punimeve në trafostacionin e dedikuar për konsumatorin Burgu i Sigurisë së Lartë, ku të gjitha kërkesat e PEE nr. 7176 të datës 31.10.2013 kanë qenë të plotësuar, duke përfshirë TMRR 1500/5A.

Nga prova Vendim për formim të komisionit, pa datë, pa numër; gjykata ka konstatuar se KEDS ka themeluar komisionin për analizimin e të gjitha aspekteve teknike të kthinës dalës 10(20)kV nga TS 35/10kV Batallavë, LP 10(20)kV, TS 10(20)/0.4kV dhe pikave matëse sipas PEE nr. 7176 të datës 31.10.2013.

Nga provat Leje hyrje nr. 7508 e datës 05.11.2013 dhe Vendim i KEDS i datës 16.07.2017 gjykata ka konstatuar se punimet në ndërtimin e kthinës 10(20)kV, LP 10(20)kV dhe TS 10(20)/0.4kV dhe pikave matëse – Burgu i Sigurisë së Lartë (sipas PPE nr. 7176 i datës 31.10.2013 janë bërë nën mbikëqyrjen e punëtorëve të autorizuar të KEDS.

Nga provat Kërkesë për kyçje nr. 7964 e datës 14.11.2013 dhe Kërkesë për kyçje e datës 12.11.2013, gjykata ka konstatuar se menaxheri i rrjetit nga distrikti Prishtinë i KEDS ka kërkuar kyçjen në TS 10(20)/0.4 kV dhe LP 10(20) kV, pasi që janë plotësuar kushtet mbi ndërtimin e kthinës 10(20) kV, dhe LP 10(20) kV, nga pëlqimi elektroenergjetik nr. 7176 i datës 31.10.2013 për furnizim me energji elektrike.

Nga prova Transaksionet e konsumatorit për periudhën 05.01.2014 deri 16.12.2016 gjykata konstatoi se paditësi ka bërë korrigjimin e faturës fillimisht me datë 18.09.2014 në shumë prej 22,157.06 dhe pastaj me datë 18.12.2014 shumën prej 28.150.49€.

Nga provat Korrigjimi i kërkuar nga departamenti i KEDS nr. 1418 dhe Kalkulime në tabela në gjashtë faqe, gjykata konstatoi se paditësi ka bërë korrigjimin e shumës së shpenzimit për konsumatori MAP Burgu i Sigurisë së Lartë, ashtu që ka bërë shtimin e shumës prej 28,150.49€ sipas procesit 1242254 të datës 02.12.2014 sipas energjisë së regjistruar në njehsorit 35704746 me konstantë  $C=300$ .

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka aprovuar ankesën e konsumatorit MAP Burgu i Sigurisë së Lartë dhe ka obliguar KESCO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR-90091132 nga korrigjimi nr. 70543DPR-90091132 i datës 18.12.2014 në vlerë 28,150.49€.

Gjithashtu gjykata e ka vlerësuar si të drejtë arsyetimin e ZRRE se njehsori nr. 35704746 nuk ka qenë njehsor kontrollues ashtu siç e cilëson paditësi dhe në bazë të të cilit bënë korrigjimin e shpenzimeve ashtu që krahasimi i njehsorit elektrik nr. 97830487 dhe njehsorit elektrik nr. 35704746 nuk mund të jep gjendjen reale të konsumatorit duke pasur parasysh se edhe përkundër korrigjimit të kWh me faktorin e korrigjimit, shpenzimet e korrigjuara si dhe ato të tanishmet në dy njehsorët nuk mund të jenë identike në asnjë rast për shkak të karakteristikave të ndryshme të pikave matëse si dhe për shkak të mos sinkronizimit të saktë të pajisjeve matëse. Po ashtu gjykata e vlerësoi si të drejtë arsyetimin e të paditurit në vendimin kontestuese se paditësi ka bërë matjen e energjisë elektrike në kundërshtim me Pëlqimin Elektroenergjetik dhe se paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë se Pëlqimi Elektroenergjetik është reviduar për tu bërë matja e shpenzimit të energjisë ndryshe nga ajo çfarë është përcaktuar në PEE.

Gjykata e vlerësoi si të drejtë arsyetimin e të paditurit në vendimin kontestuese duke u bazuar në procesverbalin nr. 7664 të datës 07.11.2013 dhe raportin teknik nr. 7938 të datës 13.11.2013 nga ku vetë paditësi ka konstatuar se konsumatori Burgu i Sigurisë së Lartë ka bërë ndërtimin e objekteve elektrodistributive sipas projekteve të aprovuara nga ana e investitorit dhe të njëjtat janë ndërtuar në harmoni me rregullat dhe normat ekzistuese për objektet e këtij lloji dhe po ashtu paditësi ka bërë pranimin teknik të punimeve në trafostacionin e dedikuar për konsumatorin Burgu i Sigurisë së Lartë.

Gjithashtu faktin se njehsori elektrik nr. 35704746 nuk ka qenë njehsorë kontrollues gjykata e konstatoi nga procesverbali nr. 1242254 i datës 02.12.2014 pasi që në këtë procesverbal askund nuk theksohet se i njëjti është njehsor kontrollues madje në këtë procesverbal konstatohet se ky njehsor dhe TMRR nuk janë të pllombuara.

Gjykata vlerëson se përdorimi i të dhënave nga njehsori i cili nuk është i vulosur me pllomba shtetërore është në kundërshtim me nenin 3.2.1 të Kodit i Matjes i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (mars 2014, versioni 1.1) (më tutje referuar si Kodi i Matjes) i cili përcakton: “... Të gjithë njehsorët para se të bëhet instalimi i tyre duhet që të lejohen për përdorim, testohen dhe të vulosen me pllomba shtetërore sipas procedurave të Meteorologjisë nga MTI.”

Po ashtu në nenin 5.1.3 të Kodit të Matjes janë përcaktuar përkufizimet e termeve si në vijim: “Njehsori Kryesor dhe Njehsori Kontrollues: Njehsori primar, i cili përdoret për qëllime të faturimit, emërohet si Njehsori Kryesor. Njehsori kontrollues përdoret si mbështetje e Njehsorit Kryesor për qëllime të faturimit, atëherë kur Njehsori Kryesor nuk mund të regjistrojë ose bëjë gabime më të mëdha se sa që janë të lejuara me standard.” Ndërlidhur me këtë, në nenin 3.8.2 të Kodit të Matjes është përcaktuar se: “Të gjithë njehsorët dhe pajisjet matëse duhet të ri-kalibrohen ose ri-atestohen dhe pllombohen me pllomba shtetërore periodikisht sipas intervaleve të përcaktuara dhe të definuara sipas prodhuesit gjegjësisht standardeve relevante ndërkombëtare IEC standardeve ( SK EN ; 50470-3, 62056-21, 62052-11, 52056- 46 dhe ato SK EN; 62053.. ) për matje dhe sipas rregulloreve të përcaktuara nga MTI.”

Gjithashtu, gjykata vlerëson se paditësi me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshëm faktin se njehsori nr. 35704746 është montuar nga punëtorët e autorizuar të paditësit me qëllim që të shërbej si njehsor kontrollues i njehsorit kryesor nr. .... për të cilin ekziston procesverbali mbi montimin nr. 021718 i datës 22.11.2013, ashtu siç do të duhej të ekzistonte edhe për njehsorin kontrollues nr. 35704746 në mënyrë që matja e bërë të merret parasysh si matje e saktë.

Lidhur me përkufizimin e termeve “Marrëveshje e Kyçjes” dhe “Pika e Matjes”, në nenin 5.1.3 të Kodit të Matjes është përcaktuar si në vijim: “Marrëveshja e Kyçjes: Një marrëveshje dypalëshe në mes OSSH-së dhe çdo Përdoruesi të Sistemit të Shpërndarjes, që përmban tërësinë e kushteve për kyçje në Sistemin e Shpërndarjes” dhe “Pika e Matjes: Pika e matjes është vendi fizik, ku është instaluar sistemi i matjes së energjisë elektrike dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike. Pika fizike e matjes përcaktohet plotësisht nga marrëveshjet midis Palëve.”

Neni 3.1.1 dhe 3.1.2 i Kodit të Matjes përcakton se: “3.1.1. Pika matëse është pika ku bëhet matja e shkëmbimit të energjisë elektrike në mes të Sistemit të Shpërndarjes, të Sistemit të



*Transmisionit, Gjeneruesve të pavarur, konsumatorëve dhe përdoruesve tjerë, e vendosur në pikat ndarëse - kufizuese (ose sipas marrëveshjes) të arritura ndërmjet palëve të ndërsjella;*  
*3.1.2. Pajisjet matëse që vendosen në pikat matëse duhet që të masin rrjedhjen e energjisë elektrike, siç është Energjia dhe Fuqia Aktive dhe Reaktive, në mënyrë të saktë në çdo interval të caktuar kohor.”*

Ndërlidhur me dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se paditësi dhe konsumatori përmes Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 7176 të datës 31.10.2013 kanë përcaktuar tërësinë e kushteve për kyçje në Sistemin e Shpërndarjes dhe kanë përcaktuar Pikën e Matjes, e cila në bazë të pranimit teknik të bërë nga i paditësi i ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë. Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit se përmes procesverbalit mund të bëhet ndërrimi i pikës matëse dhe për këtë nuk është e nevojshme revidimi i PEE, janë në kundërshtim me nenin 5.1.3 dhe 3.1.1 të cilat përcaktojnë qartë se pika matëse përcaktohet plotësisht nga marrëveshjet midis palëve e në këtë rast marrëveshja midis palëve ka qenë Pëlqimi Elektroenergjetik i datë 31.10.2013.

Po ashtu duke qenë se pajisjet matëse që janë vendosur në pikat matëse janë përcaktuar nga vetë paditësi në PEE dhe të njëjtat janë vendosur në përputhje me PEE, gjykata vlerëson se matja e bërë në këtë pikë matëse është i vetmi burim i besueshëm i llogaritjes së shpenzimit të energjisë nga konsumatori. Andaj, gjykata vlerëson se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura kur ka bërë korrigjimin e shpenzimit të energjisë së shpenzuar bazuar në procesverbalin nr. 1242254 të datës 02.12.2014 bazuar në shënimet e marra në njehsorin elektrik i cili nuk ka qenë i dedikuar si njehsor kontrollues e as nuk është vendosur sipas Pëlqimit Elektroenergjetik dhe kushteve të përcaktuara në nenin 3.8.2 të Kodit të Matjes lidhur me pllombimin e njehsorit elektrik.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditësit të dhëna në padi dhe në seancën gjyqësore se mospërputhjet e vendit të pikës matëse me PEE dhe defektet në matje nuk do të thotë se energjia e shpenzuar nga konsumatori nuk duhet të faturohet, por këto pretendimet i vlerësoi të paqëndrueshme për faktin se asnjë matje e energjisë së shpenzuar përtej matjeve me njehsorin kryesor nr. ..., nuk është bërë në përputhje me rregullat e Kodit të Matjes, andaj të njëjtat nuk mund të merren për bazë si matje të sakta.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit Burgu i Sigurisë së Lartë në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë

gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.16/22, datë 18.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.